

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiq, kryetar, Erdogan Haxhibeqiri dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në konfliktin administrativ të paditësve Z. Sh. nga F., Sh. K. dhe E. Sh. nga D.-Shipëri, H. Gj. nga P., E. K. nga fsh.R. i R.-L., I. G. dhe I. Sh. nga F., përfaqësuar nga B. M., avokat nga Gj., kundër të paditurës Banka Qendrore e Kosovës (BQK), përfaqësuar nga D. P., avokat nga P., me bazë juridike anulim i vendimit nr... dt....., duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditësve, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA.UZH.nr.408/2016 të datës 18.07.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 30.10.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e paditësve Z. Sh. e të tjerëve, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA.UZH.nr.408/2016 të datës 18.07.2017.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AA.UZH.nr.408/2016 të datës 18.07.2017, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësve Z. Sh. e të tjerëve, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore- Departamentit administrativ A.U.nr.440/11 dt.14.10.2007 me të cilin është hedhur poshtë si e pasafatshme padia e paditësve lidhur me anulimin e vendimit e të paditurës BQK nr.. dt.....

Paditësit, kësaj gjykate në afat ligjor e kanë parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, për shkak të shkeljeve të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar kërkesa, ndërsa aktgjykimi i kontestuar të ndryshohet dhe të aprovohet kërkesëpadia, ose të anulohet aktgjykimi i kontestuar dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, avokati D. P. në përgjigje në kërkesë, pretendimet e paditësve i ka kontestuar si të pabazuara, me propozim që kërkesa të refuzohet dhe të vërtetohet aktvendimi i kontestuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimeve të goditur, kërkesës së paditësve për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, përgjigjës në kërkesë dhe shqyrtimit të shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Kërkesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.408/2016 dt.18.07.2017 është refuzuar ankesa e paditësve Z. Sh. e të tjerë, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Thmelore në Prishtinë - Dep.administrativ A.U.nr.440/11 dt.14.10.2017 me të cilin është hedhë poshtë si e pasafatshme kërkesëpapia e paditësve lidhur me anulimin e vendimit të të paditurës – BQK) nr.. dt.....

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, gjen se gjykata e shkallës së dytë ka vendosur drejtë kur ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësve. Qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo Gjykatë, ngase aktgjykimet e goditura nuk janë përfshirë me shkelje të së drejtës materiale, siç pretendojnë paditësit në kërkesë.

Me nenin 13 të LKA parashihet se konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, dhe se konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar. Neni 14 i këtij Ligji parashikon se konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë Ligj ('heshtja e administratës'). Neni 62.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2001/24 (Ndryshim i Rregullores nr.1999/20) përcakton se rregullat dhe urdhëresat e BQK-së janë vendime përfundimtare në procedurën administrative. Interpretimi i drejtë i këtyre dispozitave nënkupton se vendimi i të paditurës -BQK nr.. dt..... është përfundimtar, kundër të cilit ankimi nuk është i lejuar, por mund të inicohet konflikti administrativ. Në rastin konkret nuk ka 'heshtje të administratës', por bëhet fjalë për aktin përfundimtar të organit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit nuk mund të fillojë konflikti administrativ.

Dispozita e nenit 27 par. 1 të LKA-së parashikon se padia paraqitet brenda (30)ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës. Afatshmëria e padisë vlerësohet sipas provave-shkresave të lëndës të cilat vërtetojnë datën e dorëzimit të aktit kontestues, si dhe datën e ngritjes së padisë në gjykatë. Ngase, të dy gjykatat në mënyrë të drejtë kanë vërtetuar se vendimin e të paditurës nr.. të datës..... paditësit e kanë pranuar me 20.03.2006 përmes përfaqësuesit të autorizuar (të atëhershëm)-avokatit T. G.. Poashtu, këto gjykatat drejtë kanë vërtetuar se paditësit kanë paraqitur padinë në gjykatë me datën 20.05.2011, meqenëse figuron vula e gjykatës për pranimin, pra pas afatit prej 30 ditësh nga data kur ka filluar të rrjedh afati për parashtrimin e padisë, andaj kjo Gjykatë konstaton se gjykatat e instancave më të ulëta me të

drejtë kanë hedhur poshtë padinë e paditësve sepse kanë paraqitur padinë pas kalimit të afatit ligjor.

Si më sipër, Gjykata Supreme konstaton se pretendimet e paditësit janë të pabazuara ngase aktgjykimi i shkallës së dytë përmbanë arsye të mjaftueshme dhe se janë vlerësuar të gjitha faktet në këtë çështje juridike, se vendimi i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm, se edhe e drejta materiale, po ashtu është zbatuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Nga të lartcekurat, e në zbatim të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konflikte Administrative, u vendos sinë dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
ARJ.UZVP.nr.60/2017, më datë 30.10.2017

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Nebojsa Boriçiq

Përktheu: Ferid Abazi